



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.639/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik “AL Engineering” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “PROing” Sh.p.k.; “Fidan Hasanaj” B.I.; “Artings Project” Sh.p.k. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal – Deçan, më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AL Engineering”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal – Deçan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 07.09.2020 me nr. 639/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese, me nr. të prokurimit: 631-20-1872-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal – Deçan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.09.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 17.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se anëtari i konsorciumit Fidan Hasaj B.I. nuk i plotëson të gjithë kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate përkatësisht kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2, pasi nuk i ka dorëzuar fare deklaratat vjetore tatimore për vitin 2019, andaj kërkesa e lartpërmendur nuk e është përmbushur dhe OE i rekomanduar për kontrate është dashur të shpallet i papërgjegjshëm, si dhe anëtari tjetër i konsorciumit Artings Project Shpk, nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin financiar dhe mundësit teknike – profesionale, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ky grup i OE dhe jo të rekomandohet për kontrate.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, anëtari i grupit Fidan Hasaj B.I. ka prezantuar Deklaratat tatimore vjetore për vitin 2017 dhe 2019, gjithashtu edhe lideri i grupit “PROing & Partners” Shpk, ka prezantuar deklaratat tatimore vjetore,

kurse anëtarit tjetër Artings Projekt Shpk, nuk ka prezantuar dëshmi mbi qarkullimin financiar, mirëpo duke pas parasysh nenin 71 par. 4 të LPP-se, ku thotë: “Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit” si dhe bazuar në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2 të FDT-se, po citoj: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 240,000.00 € (në rast konkursiumi 2 3 e vlerës për liderin). Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, prandaj bazuar në dëshmitë e prezantuar nga grupi i OE dhe kërkesë në FDT, grupi i operatorëve ekonomik ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grupi OE i rekomanduar për kontratë, Diploma e inxhinierit ndërtimtarisë Diamant Kabashi është e pa noterizuar, ndërsa në FDT shkruan qartë tek dëshmia e kërkuar se diplomat në lidhje me stafin profesional duhet të jenë të noterizuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, anëtarin e grupit Fidan Hasa B.I. ka prezantuar inxh. i Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktive, z. Dijamant Kabashi, mirëpo diploma e tij nuk është e noterizuar tek noteri, ashtu siç është kërkuar tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, nenin 9.1 & 9.2 FDT, ku thotë: “Dipomat kopje të noterizuar”.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkojë sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 të RrUOPP-së. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grupi OE i rekomanduar për kontratë, është i papërgjegjshëm edhe për faktin se inxhinieri i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë Enver Gashi nuk ka referencë në hartim të projekteve (që e tregojnë përvojën e punës së kërkuar) pas diplomimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, anëtarin e grupit Fidan Hasa B.I. ka prezantuar inxh. i Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi

Konstruktive, z. Enver Gashi, për të cilin ka prezantuar Diplomen kopje të noterizuar, CV, kontratën për punën specifike dhe disa referenca në pozitën: Menaxher i projektit në disa projekte, mirëpo nuk ka prezantuar referenca në hartimin e projekteve ashtu siç është kërkuar tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nënien 9.1 & 9.2 FDT, ku thotë: “Referenca në hartim të projekteve (që e tregojnë përvojën e punës së kërkuar)”.

Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkojë sqarime shtesë bazuar nënien 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar nënien 39 të RrUOPP-së. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendim nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grupi OE i rekomanduar për kontratë, anëtar i këtij grupi OE PROing & Partners” Shpk ka ofruar inxhinierin e ndërtimit – drejtimin Infrastruktura Shaban Idrizi, i cili inxhinier është diplomuar në Maqedoni në vitin 1992 dhe diploma e tij është e pa-notifikuar d.m.th. OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, lideri i grupit ka prezantuar Inxh. i dip. i ndërtimit – drejtimin Rrugor dhe Hekurudhor, z. Shaban Idrizi i cili me datë 15.06.1992 përfundon të gjitha provimet në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi” në Shkup – Republika e Maqedonisë, të përkthyer nga përkthyesi i autorizuar Gjygjësorë, gjithashtu grupi i OE së bashku me dokumentet e tenderit përmes platformës elektronike e-prokurim ka ngarkuar edhe Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 12-2018 (Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës), dhe bazuar nënien 3 par. 16, po citoj: “Këtij udhëzim nuk i nënshtrohet njohja dhe barasvlera e diplomave/kualifikimeve: 16.1 Të fituara/lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë funksionuar në territorin administrativ të ish-Jugosllavisë deri në vitin 1992”, prandaj duke marrë për bazë udhëzimin administrativ (MASHT) Nr. 12-2018, atëherë kjo diploma plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nënien 9.1 & 9.2 të FDT-së ku thotë: (të diplomuarit jashtë vendit, diploma të jetë e notifikuar në Kosovë). Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK në lidhje me arsyen tone te eliminimit ku e keni cekur se “Gabimi aritmetikore i evedntuar është me shume se dy perqind (2%) i vlerës totale te ofertës”, ju sqarojmë se kjo arsye nuk qëndron për arsyet ne vijim:

Në vijim po paraqesim tabelën me çmime e cila tregon se ne nuk kemi bere ndonjë gabim aritmetikor:

HARTIMI I PROJEKTEVE

A	Rrugët, Objekte të rrugës, Matje Gjeodezike, Elaborate, Plane rregullative dhe Hapësira Publike	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi I Projektit Kryesor Zbatues, i rrugëve në pjesën urbane - me dy kursi	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues i shtegut për biciklist në zonën Urbane	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
3	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i rrugëve në pjesën rurale - me dy kursi	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
4	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtegut për biçiklist në zonën Malore	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i trotuareve në zonën Urbane dhe Rurale	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
6	Hartimi I planit rregullatib për Bjeshken e Belegut	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
7	Matjet gjeodezike për kufive kadastral të pronave, rrugëve,trotuarëve, shtigjeve për biçiklist dhe kanaleve të ujitëjes	m'	€ 0.45	€ 0.01	€ 0.15
8	Matjet gjeodezike i Sipërfaqeve të pronave Komunale dhe Private	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
9	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Urave deri 10 m	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
10	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Urave mbi 10 m	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01

11	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Mureve Mbrojtëse	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
12	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i parkingjeve	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
13	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i parqeve dhe shesheve	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
14	Hartimi i elaborateve për VNM	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
15	Hartimi i elaborateve të shpronsimit (elaboratet e shpronesimit)	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
16	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
					€ 0.30

B	Infrastruktura hidroteknike	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Totali i projektimi t per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (34 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Atmosferik ne zona Urbane	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Atmosferik ne zona Rurale	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
3	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Rrjetit te Ujësellsit në Bjeshkë e Deçanit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
	Projekti i Rezervarve të ujit për pije në Bjeshkë të Deçanit	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Rurale (Ri - Projektim)	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Rurale (Projekt i Ri)		€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01

6	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Urbane (Ri - Projektim)	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
7	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtratit të perroit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
8	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtratit të lumit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
9	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Rezervarve të Ujitë (Kaptazhes) për ujësjellsin e Qytetit	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
10	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i rregullimit të hapësirave për rreth Rezervarve të ujitë (Kaptazhav)	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
11	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Pendave të Ujitë në shtratin e lumit për furnizimin e kanaleve të ujitëjes më ujië për tokat bujqësore.	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
12	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i impiantev për trajtimin e ujrave të zeza prej 500-9000 banor	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
13	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i impiantev për trajtimin e ujrave të zeza prej 9000-20000 banor	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
14	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues i Kanaleve Ujitëse me elemente përcjellese	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
B - gjithsejt (1-15):					€ 0.15

C	Ndërtim i Lartë	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Totali i projektimi t per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve deri në 500 m ²	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve 500- 2000 m ²	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01

3	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve mbi 2000 m ²	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
4	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për renovimin e objekteve institucionale		€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i instalimeve elektrike në objektet e institucioneve Komunale	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
6	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i instalimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit në objektet e institucioneve Komunale	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
7	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për Memoriale	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
8	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për varreza të Dëshmorve	m ²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01
C- Gjithësej (1-8)					€ 0.08

REKAPITULLIM	
Situacionet	Çmimi total i peshuar
A - Gjithsej (1-16):	€ 0.30
B - Gjithsej (1-14):	€ 0.15
C- Gjithësej (1-8)	€ 0.08
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.	€ 0.53

Te pjesa A dhe C e paramases:

-Kur e shumëzojmë çmimin njësi sipas dosjes $0.03 \times 33\% = 0.0099$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01 €) – sipas dosjes se tenderit.

-Ne rastin kur e mbledhim ri-projektimin $(0.03 + 0.01) \times 33\% = 0.0132$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01 €) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

E njëjta vlen edhe për pozicionet A.7 – $0.45 \times 33\% = 0.1485$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.15 €) – sipas dosjes se tenderit.

Me rasatin e mbledhjes se Ri-projektimit te pozicioni a.7 – $(0.45 + 0.01) \times 33\% = 0.1518$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.15 €) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

Rasti te pjesa B e paramases:

-Edhe te kjo pjese e njëjta $0.03 \times 34\% = 0.0102$ (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01) – sipas dosjes se tenderit.

-Edhe ne rastin kur mbledhim ri-projektimin $(0.03+0.01) \times 34\% = 0.0136$ (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, si dhe duke u bazuar ne nenin 18.4 RrUOPP, po citoj: “Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre”. OE ankues ne këtë aktivitet te prokurimit ne paramasen – përshkrimin e çmimeve ka ofertuar me çmimin për njësi si ne tabelen më lartë.

Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron, duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe listën e çmimeve/paramasen dhe parallogarit ne Excel si pjesë e dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues askund nuk ka njoftuar OE se.: “Nëse ndodhë ndonjë gabim në plotësimin e paramases AK nuk mbanë përgjegjësi”. Operatorët ekonomik, përgatitin tenderët e tyre në bazë te dosjes së tenderit si dokument themelorë dhe gjithashtu, vlerësimi i tenderëve bëhet ne bazë te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate (dosja e tenderit duhet te hartohet/përpilohet dhe përgatitet ne harmoni me RrUOPP-së dhe prap vlerësimi do të bëhet në pajtim me dosjen e tenderit - listën e çmimeve), po ashtu zyrtaret e prokurimit janë te obliguar ta njohin LPP dhe te veprojnë ne harmoni me dispozitat ligjore dhe rregulloreve ne fuqi te hartojnë dhe përgatisin dokumentet e tenderit dhe jo te eliminojnë operator ekonomik për gabimet qe kanë rrjedhur me fajin AK, pasi AK tek përshkrimi i çmimeve formulat ne Excel i kanë dhënë gabim si në vijim: $(=E25*34\%; =E25*34\%; =E43*33\%)$, kurse është dashur të jenë: $[(E6+F6)*33\%; =(E25+F25)*34\%; =(E43+F43)*33\%]$, mirëpo edhe për kundër kësaj, këto Poentimi do të përdoren vetëm për qëllimin e artikulimit te rëndësisë se secilit shërbim apo artikull, dhe për të qenë në gjendje për të zgjedhur ofertën me çmimin më të ulët, sepse fatura do të lëshohet në çdo rast në bazë të sasive reale dhe jo çmimeve te peshuara, andaj bazuar ne nenin 28.14 te RRUOPP, po citoj: “Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është qe të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit te ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit te hapjes se ofertave”, prandaj nuk mund te llogaritet si gabim aritmetik çmimi total i poentuar sepse AK, nuk mund ta aplikoj nenin 59 par 3 të LPP-se tek çmimi i poentuar. Duke u bazuar

ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë, është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 7, 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, tek letrat standarde te eliminimit dhe tek vendimi i ZPP ne refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te datës 26.08.2020, OE ankues eliminohet për gabime aritmetikore mbi 2%, andaj me rastin e rivlerësimit te respektohet ne tërësi nenin 7, 59, te LPP-së, andaj është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, dhe te trajtoj dhe analizoj çmimin e secilit operator ekonomik ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE: “AL Engineering” Sh.p.k. – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim

Autoriteti Kontraktues me datë 18.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 21.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, përveç me pikën 4, ku sqaron se nëse njihen diplomat e ish-Jugosllavisë deri 1992 kjo nuk vlen për shtetin e Maqedonisë se Veriut pasi ajo nuk është pjese e Jugosllavisë nga 1991 (me saktësisht dita e pavarësisë se Maqedonisë është 8 shtator 1991) dhe inxhinieri ne fjalë Shaban Idrizi i

cili ka diplomuar ne vitin 1992 është dashtë ti konfiskohet diploma. Ne seancën qe do te mbahet, dëshirojmë te marrim pjese dhe ti dëshmoj faktet tona.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë, pasi qe për këtë lende te dy palët janë pajtuar qe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se anëtari i konsorciumit Fidan Hasaj B.I. nuk i plotëson te gjithë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2 , pasi nuk i ka dorëzuar fare deklaratat vjetore tatimore për vitin 2019, andaj kërkesa e lartpërmendur nuk është përmbushur dhe OE i rekomanduar për kontratë dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Më tej, OE ankues shton se edhe anëtari tjetër i konsorciumit Artings Project Shpk, nuk ka ofruar dëshmi për qarkullimin financiar dhe mundësitë teknike-profesionale, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ky grup i OE dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i grupit Fidan Hasaj B.I. ka prezantuar deklaratat tatimore vjetore për vitin 2017 dhe 2019. Gjithashtu, edhe lideri i grupit “PROing & Partners” Shpk, ka prezantuar deklaratat tatimore vjetore, kurse anëtarit tjetër “Artings Projket” Shpk, nuk ka prezantuar dëshmi mbi qarkullimin financiar. Mirëpo, duke pas parasysh nenin 71 par. 4 të LPP-së, ku thotë: “Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”, si dhe bazuar në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2 të FDT-së, ku thuhet: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 240,000.00 € (në rast konsorciumi 2/3 e vlerës për liderin). Dëshmia 1. Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në dëshmitë e prezantuar nga grupi i OE dhe kërkesë në FDT, grupi i operatorëve ekonomik ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, se grupi i OE të rekomanduar për kontratë për inxhinierin e ndërtimtarisë Diamant Kabashi diplomën e ka të pa noterizuar, ndërsa në FDT shkruan qartë tek dëshmia e kërkuar se diplomat në lidhje me stafin profesional duhet të jenë të noterizuara. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i grupit Fidan Hasa B.I. ka prezantuar inxh. i Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktive, z. Dijamant Kabashi. Mirëpo, diploma e tij nuk është e noterizuar tek noteri, ashtu siç është kërkuar tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, nenin 9.1 & 9.2 FDT, ku thotë: “Diplomat kopje të noterizuara”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 të RrUOPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, se grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se inxhinieri i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë Enver Gashi nuk ka referenca në hartim të projekteve (që e tregojnë përvojën e punës së kërkuar) pas diplomimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se anëtari i grupit Fidan Hasa B.I. ka prezantuar inxh. i Dipl. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv, z. Enver Gashi, për të cilin ka prezantuar diplomën kopje të noterizuar, CV, kontratën për punë specifike dhe disa referenca në pozitën: Menaxher i projektit në disa projekte. Mirëpo, nuk ka prezantuar referenca në hartimin e projekteve ashtu siç është kërkuar tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 FDT, ku thotë: “Referenca në hartim të projekteve (që e tregojnë përvojën e punës së kërkuar)”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 të RrUOPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, se grupi i OE të rekomanduar për kontratë, anëtari i këtij grupi OE PROing & Partners” Shpk ka ofruar inxhinierin e ndërtimtarisë – drejtimi Infrastrukturë Shaban Idrizi, i cili inxhinier është diplomuar në Maqedoni në vitin 1992 dhe diploma e tij është e pa notifikuar d.m.th. OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lideri i grupit ka prezantuar Inxh. i dip. i ndërtimtarisë drejtimi Rrugor dhe Hekurudhor, z. Shaban Idrizi i cili me datë 15.06.1992 përfundon të gjitha provimet në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi” në Shkup – Republika e Maqedonisë, të përkthyer nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor. Gjithashtu, grupi i OE së bashku me dokumentet e tenderit përmes platformës elektronike e-prokurim ka ngarkuar edhe Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 12-2018 (Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave Gradave dhe

Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës), dhe bazuar në nenin 3 par. 16, ku thuhet: “ Këtij udhëzimi nuk i nënshtrohet njohja dhe barasvlera e diplomave/kualifikimeve: 16.1 Të fituara/lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë funksionuar në territorin administrativ të ish-Jugosllavisë deri në vitin 1992”. Prandaj, Paneli Shqyrtues duke marr për bazë udhëzimin administrativ (MASHT) Nr. 12-2018, ku në këtë Udhëzim Administrativ shprehimisht ceket “deri në vitin 1992”, kurse inxhinieri i apostrofuat ka përfunduar me datë 15.06.1992, atëherë kjo diplomë plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së ku thotë: (të diplomuarit jashtë vendit, diploma të jetë e nostrifikuar në Kosovë). Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, se AK në lidhje me arsyen tone të eliminimit ku e keni cekur se “Gabimi aritmetikor i evidentuar është me shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës”, OE ankues ka bashkangjitur në ankesë tabelën me çmime ku pretendon se nuk kemi bërë ndonjë gabim aritmetikor. Më, tej OE ankues shton se te pjesa A dhe C e para masës:

Kur e shumëzojmë çmimin njësi sipas dosjes $0.03 \times 33\% = 0.0099$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01 €) – sipas dosjes se tenderit.

Ne rastin kur e mbledhim ri-projektimin $(0.03+0.01) \times 33\% = 0.0132$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01 €) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

E njëjta vlen edhe për pozicionet A.7 – $0.45 \times 33\% = 0.1485$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.15 €) – sipas dosjes se tenderit.

Me rasatin e mbledhjes se Ri-projektimit te pozicioni a.7 – $(0.45+0.01) \times 33\% = 0.1518$ € (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.15 €) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

Rasti te pjesa B e paramases:

Edhe te kjo pjese e njëjta $0.03 \times 34\% = 0.0102$ (pasi duhet te jete dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01) – sipas dosjes se tenderit.

Edhe ne rastin kur mbledhim ri-projektimin $(0.03+0.01) \times 34\% = 0.0136$ (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros – rrumbullakohet 0.01) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, si dhe duke u bazuar ne nenin 18.4 RrUOPP, ku thuhet: “Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit në para masën – përshkrimin e çmimeve ka ofertuar me çmimin për njësi si në tabelën e cekur më lartë në raportin e ekspertizës.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe listën e çmimeve/paramasen dhe parallogarit në Excel si pjesë e dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues askund nuk ka njoftuar OE se “Nëse ndodhë ndonjë gabim në plotësimin e paramases AK nuk mbanë përgjegjësi”. Operatorët ekonomik, përgatitin tenderët e tyre në bazë të dosjes së tenderit si dokument themelor dhe gjithashtu vlerësimi i tenderëve bëhet në bazë të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë (dosja e tenderit duhet të hartohet/përpilohet dhe përgatitet në harmoni me RrUOPP-së dhe prapë vlerësimi do të bëhet në pajtim me dosjen e tenderit - listën e çmimeve). Po ashtu, zyrtarët e prokurimit janë të obliguar ta njohin LPP dhe të veprojnë në harmoni me dispozitat ligjore dhe rregulloreve në fuqi të hartojnë dhe përgatisin dokumentet e tenderit dhe jo të eliminojnë operatorët ekonomik për gabimet që kanë rrjedhur me fajin AK, pasi AK tek përshkrimi i çmimeve formulat në Excel i kane dhënë gabim si në vijim: ($=E25*34\%$; $=E25*34\%$; $=E43*33\%$), kurse është dashur të jenë: [$=(E6+F6)*33\%$; $=(E25+F25)*34\%$; $=(E43+F43)*33\%$]. Mirëpo, edhe për kundër kësaj, këto poentime do të përdoren vetëm për qëllimin e artikullimit të rëndësisë së secilit shërbim apo artikull, dhe për të qenë në gjendje për të zgjedhur ofertën me çmimin më të ulët, sepse fatura do të lëshohet në çdo rast në bazë të sasive reale dhe jo çmimeve të peshuara. Andaj, bazuar në nenin 28.14 të RRUOPP, ku thuhet: “Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave”. Prandaj, nuk mund të llogaritet si gabim aritmetik çmimi total i poentuar sepse AK, nuk mund ta aplikoj nenin 59 par 3 të LPP-se tek çmimi i poentuar. Pra, pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “AL Engineering”- Prishtinë, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 7, 59 të LPP-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron AK – komisioni i vlerësimit, tek letrat standarde të eliminimit dhe tek vendimi i ZPP në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.08.2020, OE ankues eliminohet për gabime aritmetikore mbi 2%, andaj me rastin e rivlerësimit të respektohet në tërësi neni 7 dhe 59 i LPP-së. Për më tepër, është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, si dhe të trajtoj dhe analizoj çmimin e secilit operator ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit. Krejt kjo në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, obligohet AK që me rastin e rivlerësimit të ofertave ti përmbahet kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, duke bërë

ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal - Deçan
- 1x1 OE "AL Engineering" Sh.p.k. – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.